

VENDIM
Nr. 103, datë 5.2.2020

**PËR CAKTIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË
INFORMACIONIT (AKSHI) SI NJËSI ZBATUESE PËR NGRITJEN E PORTALIT
UNIK QEVERTAR TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT DHE FINANCIMIN E TIJ
NGA FONDI I RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjes “iii”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të pikës 3, të nenit 16, dhe të pikës 1, të nenit 38, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) si njësi zbatuese për ngritjen e portalit unik qeveritar të procesit të rindërtimit.

2. Efekti financiar total prej 19 440 360 (nëntëmbëdhjetë milionë e katërqind e dyzet mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekësh të përballohet nga zëri “Fondi për rindërtim”, miratuar në buxhetin e vitit 2020 dhe të përdoret nga AKSHI, përkatësisht:

a) në masën 18 360 360 (tetëmbëdhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”; dhe

b) në masën 1 080 000 (një milion e tetëdhjetë mijë) lekë, në zërin “Shpenzime operative dhe mirëmbajtje”.

3. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave, në zbatim të këtij vendimi, kthehen në buxhetin e shtetit në zërin “Fondi për rindërtim”.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe